- Ne rast se materialet dhe pajisjet e perdorura nuk miratohen nga Mbikqyresi, keto duhet te dokumentohen me proces-verbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara referuar standardeve te percaktuara ne specifikimet teknike te projekt-zbatimit.
- Te kerkoje kryerjen e provave shpese per materialet e vendosura ne objekt, kur keto nuk jane kryer ne masen sipas vellimeve te realizuara dhe pjese se lendes se pare te furnizuar per te verifikuar cilesine. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Kur Mbikqyresi i punimeve mendon se ka demtime ne konstrukcion, kerkon te behen verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejte Mbikqyresit, shpenzimet jane ne ngarkim te Sipermaresit. Ne rast te kundert, Sipermaresi ka te drejte te kerkoje shlyerjen e shpenzimeve.
- Mbikqyresi i punimeve urdheron Sipermaresin te prishe dhe te ribeje me shpenzimet e tij, punime te bera jo me cilesine e parashikuar ne projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet, per ekzekutim teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, per çdo rast, me miratimin e Autoritetit Kontraktor per aq kohe sa ai e konsideron te arsyeshme. Ne kete rast, sipas fajtit, Mbikqyresi se bashku me Autoritetin Kontraktor dhe Sipermarresin, percaktojne zgjatjen ose jo te afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.  
Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Kontraktor për gjendjen e tij. Në rast se Autoriteti Kontraktor ka vërejtje, e njofton Sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyresi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor.

### **Ne perfundim te punimeve Mbikqyresi:**

- Merr me shkrim njoftimin per perfundimin e punimeve dhe verteton ne proces-verbal daten e perfundimit te tyre sipas projektit, te ndryshimeve te urdheruara e te kushteve te kontrates dhe brenda 30 diteve merr prej Përgjegjësit dokumentacionin perkates.
- Sipas legjislacionit ne fuqi, dorezon prane Autoritetit Kontraktor te gjitha dokumentacionin perkates per te cilin mban pergjegjesi te plote ne plotesimin, saktesine dhe vertetesine e tij.  
Ky dokumentacion duhet te permbaje:
  - *Proçes-verbalin e dorezimit te sheshit te ndertimit*
  - *Proçes-verbalin per fillimin e punimeve*

- 
- Kontraten e Siper marrjes
  - Kontraten e Mbikqyrjes
  - Projekt organizimin e punimeve
  - Projektin teknik te zbatimit
  - Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqeruar me korrespondencen, skicat perkatese dhe miratimet e nevojshme
  - Preventivin fitues
  - Preventivin e ndryshuar (nese ka zerat te rinj te punimeve, negocimin e tyre)
  - Grafikon e punimeve
  - Specifikimet teknike
  - Azhornimin para fillimit te punimeve dhe piketimi
  - Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinjerik per punime te paparashikuara
  - Proçes-verbalet e çdo punimi te maskuar te firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi
  - Ditarin e objektit ku te pasqyrohen dhe ndryshimet e urdheruara nga Mbikqyresi
  - Librezen e masave
  - Shkresen e Mbikqyresit per investitorin ku raporton perdorimin e fondit rezerve, shoqeruar me dokumentacionin perkates
  - Proçes-verbalin e perdorimit te fondit rezerve te firmosur nga Siper marresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Preventivin e fondit rezerve te firmosur nga Siper marresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Situacionin e fondit rezerve te firmosur nga Siper marresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Miratimin e materialeve te perdorura nga Mbikqyresi
  - Situacionet pjesore dhe situacioni perfundimtar
  - Regjistrin e kontabilitetit
  - Deklaraten teknike te Siper marresit te firmosur nga Siper marresi dhe drejtuesi teknik
  - Njoftimin e siper marresit per perfundimin e punimeve
  - Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Siper marresi dhe Mbikqyresi, se bashku me matjet faktike te objektit te ndertuar
  - Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit

I gjithë dokumentacioni duhet te kete miratimin e Mbikqyresit. Ky dokumentacion pergatitet e dorezohet ne 3 (tre) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë Kolaudatorit që ngrihet brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen pranë Kolaudatorit duhet të jenë origjinale.

Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne Kolaudimin e objektit dhe i pergjigjet Kolaudatorit per te gjithë dokumentacionin e nevojshem gjate kolaudimit te objektit dhe firmos. Pas perfundimit te kolaudimit, Mbikqyresi i punimeve mbeshtetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjeter, percakton vleren perfundimtare te objektit, e cila i behet e ditur Siper marresit dhe i jepet per te likuiduar Autoritetit Kontraktor.

### **Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes:**

Sherbimi i mbikqyrjes zgjat per gjithë periudhen e zbatimit te punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kerkoje largimin e Mbikqyresit kur verteton mangesi serioze ne veprimtarine e tij si:

- Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara
- Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre

- 
- Mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato te preventivuara, tolerim te materialeve jashte cilesise se kerkuar, tolerim te punimeve jo me cilesine e kerkuar, tolerim te pajisjeve jashte kushteve teknike
  - Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te urdheroje Mbikqyresin e punimeve per nderprerjen e punes deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundervajtje administrative, vendosen sanksione ne baze te legjislacionit ne fuqi.

**Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:** Sipas projektit, në fshatrat Kryekuq, Zharnec, Grabjan, Bedat, Përgjatë Lumit Shkumbin, Bashkia Divjakë.

---

## Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

---

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Sipas Shtojcës 9, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit"

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021, 2022 dhe 2023 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bere që t'i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë



---

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, per te permbushur me sukses kontraten.

Në percaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, per te permbushur me sukses kontraten.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin e fundit.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin e fundit, sipas të dhënave të QKB-së.*

*Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të DST.*

**Shënim:** *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet te mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

---

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, vlerësojme si kritere teknike të nevojshme, për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kriteret si më poshtë:**

**2.3.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Licencën profesionale të shoqërisë, për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

- **N.P - 1** Punime gërmimi në tokë
- **N.P - 2** Ndërtime civile e industriale
- **N.P - 9** Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime.

**Për punimet speciale të ndërtimit:**

- **N.S - 1** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues

*Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit që merr përsipër të realizojë.*

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të

---

punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 1 “Punime gërmimi në tokë”**:

*Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv të objektit “Nderhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemimi i ujerave ne fshatrat Grabjan, Kryekuq dhe Zharneç. Mbrojtje lumore ne lumin Shkumbin. Prita nivelngritese në kanalin kullues kryesor K 3 – 4 Bedat” tek rubrika “Punime dheu”, konkretisht këtu përfshihen zërat me emërtesë:

- Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III
- Germim dheu themele plinta b-2 m ekskavator me goma kova 0.25 m<sup>3</sup> shkarkim ne toke
- Germim kanalesh ne toke te bute, me krahe, me seksion deri 0.75 m<sup>2</sup>

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P – 2 “Ndërtime civile e industriale”**: *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv të objektit “Nderhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemimi i ujerave ne fshatrat Grabjan, Kryekuq dhe Zharneç. Mbrojtje lumore ne lumin Shkumbin. Prita nivelngritese në kanalin kullues kryesor K 3 – 4 Bedat” tek rubrika”, konkretisht këtu përfshihen zërat me emërtesë në preventivat:

- Brez b/a mbi themel
- Brez b/a mbi mure
- Plinta bazamente b/a monolite deri 20m<sup>3</sup> C20/25
- Arkitrare b/a
- Trare themeli b/a

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 9 “Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime”**.

---

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv të objektit “Nderhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemimi i ujerave ne fshatrat Grabjan, Kryekuq dhe Zhar nec. Mbrojtje lumore ne lumin Shkumbin. Prita nivelngritese në kanalin kullues kryesor K 3 – 4 Bedat” tek rubrika”, konkretisht këtu përfshihen zërat me emërtesë në preventivat:

- Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m
- Shtrese çakelli mbeturine kave t=20 cm, perhapur e ngjeshur me makineri
- Hedhje, mbushje ngjeshje dheu me krahe kategoria III

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 1 “Punime për prishjen e ndërtimeve”**: *Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihen zërat e punimeve në preventivat: “Nderhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemimi i ujerave ne fshatrat Grabjan, Kryekuq dhe Zhar nec. Mbrojtje lumore ne lumin Shkumbin Prita nivelngritese në kanalin kullues kryesor K 3 – 4 Bedat”, të seksionit me emërtesë “Heqje mbeturinash dhe prerje te bimeve të vogla”.

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 4 “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”**: *Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihen zërat e punimeve të preventivit me emërtesë “Nderhyrje emergjente nga erozioni dhe sistemimi i ujerave ne fshatrat Grabjan, Kryekuq dhe Zhar nec. Mbrojtje lumore ne lumin Shkumbin Prita nivelngritese në kanalin kullues kryesor K 3 – 4 Bedat”, të seksionit me

emërtesë: “Struktura te holla monolite betoni C 25/30”, “Pergatitje hekur betoni i zakonshem Ø > 12 mm<sup>2</sup>”, “Punime suvatimi”, “Puse kontrolli 1.5 \* 1.5 \* 1.5”

Pikat e licencës për mbikëqyrje për punimet e ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për këtë kategori licence sipas pikave përkatëse për zbatimin e punimeve.

| <b>Kategoria e kërkuar</b> | <b>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</b>                                                                                             | <b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>                                                                                                          |
|----------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>N.P - 1</b>             | Punime gjërmimi në tokë                                                                                                                                   | -Gërmim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III<br>-Gërmim dheu themele plinta b-2 m ekskavator me goma kova 0.25 m <sup>3</sup> shkarkim ne toke                                               |
| <b>N.P - 2</b>             | Ndërtime civile e industriale                                                                                                                             | -Brez b/a mbi themel<br>-Brez b/a mbi mure<br>-Plinta bazamente b/a monolite deri 20m <sup>3</sup> C20/25<br>-Arkitrare b/a<br>-Trare themeli b/a                                                              |
| <b>N.P – 9</b>             | Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime                                                                                               | -Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m<br>-Shtrese çakelli mbeturine kave t=20 cm, perhapur e ngjeshur me makineri<br>-Hedhje, mbushje ngjeshje dheu me krahe kategoria III                    |
| <b>N.S - 1</b>             | Punime për prishjen e ndërtimeve dhe prerje të bimeve të vogla                                                                                            | -Heqje mbeturinash dhe prerje te bimeve te vogla                                                                                                                                                               |
| <b>N.S - 4</b>             | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues | -Punime murature<br>-Punime shtresash “<br>-Struktura te holla monolite betoni C 25/30<br>-Pergatitje hekur betoni i zakonshem Ø > 12 mm <sup>2</sup><br>- Punime suvatimi<br>-Puse kontrolli 1.5 * 1.5 * 1.5” |

## 2. Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

b) Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune, Diplomën Universitare dhe CV.
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.
- Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder, mund të disponohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore për ekzekutimin e kësaj kontrate objekt prokurimi. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Kontratën përkatëse të punës, Diplomën Universitare dhe CV.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

*Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

**Shenim:** Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të saktë të punimeve hidraulike lidhur me zërat e preventivit të punimeve (Punime hidrosanitare).

- 
- **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi, referuar preventivit të punimeve dhe projektiti të zbatimit.

3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës, në përgatitjen e ofertës së tyre duhet të referohen Vendimit Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, si dhe të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) me Nr.6559 Prot, datë 27.06.2018 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të sipërcituara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016, “Për Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, me qëllim respektimin nga operatorët ekonomik të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuar në këtë Vendim.

***Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM Nr.354, datë.11.05.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, do të refuzohen.***

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

**Shtojca 10.****FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| Identifikimi                                                                                                                                              | Përgjigjja     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | -----          |
| Numri NIPT/et:                                                                                                                                            | -----          |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar                                                                                                           | -----<br>--    |
| Përfaqësuesi (emri):                                                                                                                                      | -----          |
| Telefoni:                                                                                                                                                 | -----<br>-     |
| E-mail:                                                                                                                                                   | -----<br>----- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

|                                                                                                                                                                                |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul> |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|



| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|-----------------------------------------------------------|
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|------------------------|--------|----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Deklarata</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme _____</p>                                 |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p> |
| <p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p>                                                                                     |

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

*Sqarime nëse vlerësohet nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*  
\_\_\_\_\_

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të

përrjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>7</sup>.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

çmimet;  
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;  
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,  
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

## **C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”**

### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

<sup>7</sup> Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

